



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1574 / prot.
13

Tiranë, më 14.06.2021

URDHËR

Nr. 183 / S, datë 14.06.2021

**PËR NJË NDRYSHIM DHE DISA SHITESA NË URDHËRIN NR. 633, DATË 17.11.2020
“PËR NDALIMIN E GRUMBULLIMEVE NË VENDE TË MBYLLYRA APO TË
HAPURA” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe në zbatim të Vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infekcionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 2435, datë 27.05.2021,

URDHËROJ:

Në Urdhërin Nr.633, datë 17.11.2020, “Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllyra apo të hapura” të ndryshuar, bëhet një ndryshim dhe disa shtesa si vijon:

1. Në pikën 1 të Urdhrit, hiqet togfjalëshi “apo të hapura, konferencat” .
2. Pas pikës 1, shtohen pika 1/1 dhe pika 1/2 me përmbajtje si vijon:

“1/1. Ndalohen grumbullimet me më shumë se 50 persona në vende të hapura, tubimet, mbledhjet partiake, ceremonitë e festave, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore nga datë 15.06.2021 deri në datë 28.06.2021. Grumbullimet sipas kësaj pike të respektojnë masat e distancimit social dhe protokollet e miratuara nga Instituti i Shëndetit Publik.

1/2. Lejohen konferencat me kapacitet të reduktuar deri në 30% të pjesëmarrësve dhe në zbatim të protokollit të miratuar nga Instituti i Shëndetit Publik nga datë 01.07.2021. ”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI
Ogerta Manastirliu